

Banka e Shqipërisë

RAPORTI GJASHTËMUJOR PËR ECURINË E
"KËRKESES MINIMALE PËR INSTRUMENTE
TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE
DETYRIME TË PRANUARA-MREL"

GJASHTËMUJORI I DYTË I VITIT 2023

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408


E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org



P Ë R M B A J T J A

| | |
|--|-----------|
| <i>PËRMBLEDHJE</i> | <i>4</i> |
| <i>I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL</i> | <i>6</i> |
| <i>II. STRUKTURA E FINANCIMIT TË MREL</i> | <i>9</i> |
| <i>III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL</i> | <i>13</i> |
| <i>IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR</i> | <i>16</i> |



PËRMBLEDHJE

Ky raport përmbledh zhvillimet kryesore të sektorit bankar në terma të përmbushjes së “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar- MREL”. Si raport i parë i hartuar për këtë qëllim, ai analizon zhvillimet kryesore për periudhën 2021-2023, pas hyrjes në fuqi të rregullores nr. 78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, me fokus të veçantë fundvitin 2023. Raporti do të përditësohet në vijim në terma gjashtëmujorë.

Në dhjetor 2023, 5 banka të sektorit bankar iu nënshtruan kuadrit rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përmbushur kërkesën për MREL. Gjatë periudhës 2021-2023, këto banka kanë ruajtur një kontribut të qëndrueshëm në zhvillimet e sektorit bankar, duke zënë një peshë prej rreth 76% të aktiveve të sektorit dhe 75% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR).

Sektori bankar ka përmbushur plotësisht kërkesën e ndërmjetme për MREL. Objektiv i ndërmjetëm i kërkesës për MREL për vitin 2023, arrin mesatarisht në 16.4% të ekspozimeve me rrezik, kundrejt objektivit të ndërmjetëm të vitit 2022 prej 14.8%. Gjatë kësaj periudhe, sektori bankar e ka përmbushur plotësisht objektivin e ndërmjetëm, duke ruajtur një kapacitet mesatar të MREL-it në intervalin 19.2%-21.4% të ekspozimeve të ponderuara me rrezik.

Bankat janë aktive në financimin e plotë të kërkesës finale për MREL. Objektiv final që duhet të përmbushet brenda vitit 2027, shënoi një zvogëlim të lehtë gjatë vitit 2023, duke arritur në nivelin 24.9% të EPR-së kundrejt 25.3% që shënonte për vitin 2022. Zvogëlimi i objektivit final gjatë vitit 2023, reflekton uljen e kërkesës mbikëqyrëse për kapital shtesë për njërin nga bankat sistemike. Emetimi për herë të parë i titujve financiarë senior gjatë vitit 2023, ka tkurrur hendekun negativ të sektorit për përmbushjen e objektivit final të MREL. Mesatarisht, hendeku negativ është zvogëluar në nivelin prej 3.5% të EPR për muajin dhjetor 2023, kundrejt nivelit 6% që shënonte në dhjetor 2022. Kapitali rregullator përbën burimin kryesor të financimit të MREL, ndërsa emetimet e titujve financiarë me përparësi të lartë (senior) gjatë vitit 2023, përbëjnë rishtazi peshën kryesore të detyrimeve të pranuar. Në dhjetor 2023, kapitali bazë i nivelit të parë ka financuar nivelin e MREL me 18.5% të EPR, kapitali i nivelit të dytë ka financuar 1.5% të EPR, borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator ka një kontribut më të ulët me 0.6% të EPR, ndërsa titujt financiarë senior kanë rritur financimin në rreth 0.9% të EPR.

Viti 2023 regjistroi një nivel të lartë të aktivitetit të bankave për emetimin e titujve financiarë për qëllime të kërkesave rregullative. Gjatë këtij viti, sektori bankar ka emetuar një shumë prej 8.4 mld lekë (nga 4.7 mld lekë në 2022) në formën e obligacioneve me ofertë private. Ky emetim përfshin borxh të varur në vlerën 5.2 miliardë lekë dhe borxh të pagarrantuar, në vlerën 3.2 miliardë



lekë. 92% e shumës së emetuar në tregun e kapitalit është kryer nga bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL, për një vlerë prej 7.8 miliardë lekësh.

Kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur këto emetime mbetet i kënaqshëm. Gjatë vitit 2023, titujt financiarë të miratuar për emetim janë blerë nga investitorët në treg, kryesisht prej individëve.


Normat e interesit në tregun e kapitalit kanë shënuar rritje, në reflektim të zhvillimeve në tregun financiar dhe emetimit të njëkohshëm të titujve të borxhit nga disa banka. Gjatë vitit 2023, norma e interesit u rrit me 2.1 pikë përqindje për emetimet në lekë, 0.9 pikë përqindje për emetimet në euro dhe 1.7 pikë përqindje për emetimet në dollarë. Piku i rritjes së normave të interesit u arrit në tremujorin e tretë të vitit 2023, duke shënuar ulje në fundvit.

Maturiteti i letrave me vlerë të emetuara në tregun e kapitalit në Shqipëri mbetet i qëndrueshëm. Instrumentet e borxhit të varur kanë afate maturimi 7-vjeçare pa reflektuar ndryshime përgjatë viteve. Ndërkohë, emetimet për herë të parë të titujve të borxhit të pagarrantuar për qëllime të MREL kanë reflektuar afate më të ulëta maturimi, në nivelin 4 vite për monedhën euro.

Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL paraqesin zhvillime mjaft pozitive në përfitueshmëri, në linjë me zhvillimet e sektorit. Në dhjetor 2023, rezultati neto nga interesi për këto banka u rrit me 11.4% në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 50.8 miliardë lekë. Marzhi neto nga interesi shënoi gjithashtu përmirësim të ndjeshëm, në nivelin historik prej 4.3% kundrejt nivelit prej 3.4% që shënonte në vitin 2022.

Në vijim të zhvillimeve të kënaqshme në treguesit e përfitueshmërisë, kostoja e financimit të kërkesës për MREL vlerësohet e përballueshme. Në dhjetor 2023, shpenzimet për interesa për borxhin e varur përbëjnë 1.5% të rezultatit neto nga interesi, për bankat të cilat i nënshtrohen kërkesës për MREL. Banka individuale të cilat kanë një histori më të gjatë të emetimit të titujve të borxhit për qëllime rregullative, kanë një peshë më të lartë të këtij treguesi, i cili gjithsesi mbetet i kufizuar në ndikimin që ka në përfitueshmëri.

Simulimet në lidhje me ndjeshmërinë e kostos së financimit të MREL ndaj rritjes së normës së interesit në treg, tregojnë për aftësi të mira të përthithjes së kostos shtesë për sektorin bankar. Gjithsesi, banka të veçanta të cilat kanë një varësi më të lartë nga rifinancimi i titujve të borxhit në treg për shkak të nivelit më të ulët të kapitalit rregullator, shfaqin një ndjeshmëri më të lartë.



I. STRATEGJIA E NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME DHE MREL

Me hyrjen në fuqi të rregullores nr. 78/2020 "Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar", Banka e Shqipërisë ka komunikuar kërkesën për MREL për secilën bankë që prej vitit 2021. Banka e Shqipërisë komunikon çdo vit nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL që bankat duhet të plotësojnë brenda 12 muajve të ardhshëm dhe nivelin përfundimtar që duhet të plotësohet brenda vitit 2027.

Duke nisur nga muaji dhjetor 2023, 5 nga 11 bankat e sektorit bankar duhet të përmbushin kërkesën për MREL¹ në zbatim të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të identifikuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo strategji nënkupton që këto banka duhet të ruajnë në bilancin e tyre burime të mjaftueshme financiare, të cilat mund të zhvlerësohen dhe konvertohen në kapital, në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në raportin në vijim, grupi i bankave që duhet të përmbushin kërkesën për MREL identifikohet si bankat MREL.

Gjatë vitit 2023, pesha e bankave MREL sipas aktiveve totale dhe nivelit përkatës të ekspozimeve të ponderuara me rrezik (EPR), ka shënuar një rënie të lehtë në terma vjetorë, por mbetet në nivelin e mesatares për periudhën 2021-2023. Për vitin 2023, këto banka përbëjnë mesatarisht 76% të aktiveve të sektorit dhe 75% të EPR. Kjo ecuri reflekton një kontribut të qëndrueshëm të aktivitetit të grupit të bankave MREL në zhvillimet e sektorit bankar gjatë periudhës së hyrjes në fuqi të kërkesave rregullative me fokus ndërhyrjen e jashtëzakonshme.


Për vitin 2022, objektivi i ndërmjetëm i kërkesës për MREL përbën mesatarisht 14.8% të EPR dhe ai final arrin 25.3% të EPR. Për vitin 2023, niveli i ndërmjetëm i kërkesës për MREL është rritur në 16.4% të EPR, ndërsa ai final shënoi një ulje të lehtë, në nivelin mesatar prej 24.9%. Tkurrja e nivelit final të kërkesës MREL gjatë vitit 2023, reflekton rishikimin në rënie të normës mbikëqyrëse të kapitalit shtesë, për njërin nga bankat sistematike².

¹ Në zbatim të ligjit nr.133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë përcakton kërkesën për MREL në përputhje me strategjinë e preferuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Bankat, të cilat identifikohen si subjekte që do t'i nënshtrohen ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duhet të plotësojnë në çdo kohë kërkesën MREL, në shtesë të kërkesës minimale për kapital rregullator. Për këtë grup bankash, kërkesa për MREL në total përfshin kërkesën për kapital rregullator dhe vlerën e nevojshme të rikapitalizimit. Për bankat e tjera që nuk parashikohet t'i nënshtrohen ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kërkesa për MREL është e barabartë me kërkesën për kapital rregullator në fuqi, pasi vlera për rikapitalizim përcaktohet si zero.

² Metodologjia për përlogaritjen vjetore të objektivit të ndërmjetëm dhe atij final të kërkesës për MREL është publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. https://www.bankofalbania.org/Nderhyrja_e_Jashtezakonshme/Planifikimi_i_nderhyrjes_se_Jashtezakonshme/Niveli_minimal_i_instrumenteve_te_kapitalit_dhe_detyrimeve_te_pranuara/




Grafik 1. Pesha në sektor për bankat me strategji ndërhyrjen e jashtëzakonshme, 2021-2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar i ka përmbushur plotësisht objektivat e ndërmjetëm të MREL për vitet 2022 dhe 2023. Gjatë kësaj periudhe, kapaciteti i bankave për kërkesën për MREL, në nivel të agreguar, është luhatur në intervalin 19.2% - 21.4% të EPR, duke qëndruar ndjeshëm mbi nivelin minimal të komunikuar nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Ecuria e kërkesës për MREL për periudhën 2022-2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, sektori bankar ka shënuar një përmbushje të plotë të objektivit të ndërmjetëm për MREL për çdo tremujor, me një tepricë që luhatet nga 3.7% deri në 6% të EPR. Në lidhje me objektivin final, sektori bankar e ka zvogëluar hendekun negativ që duhet të plotësojë deri në vitin 2027, përmes emetimeve të reja të titujve financiarë me fokus financimin e MREL. Për rrjedhojë, në dhjetor 2023, hendeku negativ që duhet të përmbushin bankat brenda vitit 2027, është ulur në 3.5% të EPR-ve në krahasim me 6% që shënonte në fund të vitit



2022. Gjithashtu, ky pozicion ende nuk i reflekton plotësisht titujt financiarë të nënshkruar nga sektori bankar gjatë vitit 2023, të cilat pritet të disbursohen gjatë periudhës 2024-2027, në linjë me afatin përfundimtar të përmbushjes së kërkesës MREL. Në mënyrë të veçantë, gjatë vitit 2023, sektori bankar në Shqipëri nënshkroi instrumentin e parë financiar me Institucionet Financiare Ndërkombëtare, që përbën dhe emetimin e parë të suksesshëm të një instrumenti MREL të këtij lloji në rajonin e Ballkanit.




Në nivel individual, bankat të cilat kanë një pozicion të kapitalit rregullator poshtë nivelit të sektorit, paraqesin një hendek më të lartë të nevojës për financim të MREL-it. Këto banka duhet të vijojnë me qasjen proaktive të financimit gradual të kërkesës për MREL, në përputhje me objektivat vjetorë që do të komunikohen nga Banka e Shqipërisë.



II. STRUKTURA E FINANCIIMIT TË MREL

Gjatë periudhës 2022-2023, sektori bankar është mbështetur kryesisht në zërat e kapitalit rregullator dhe borxhin e varur për përmbushjen e kërkesës për MREL. Tremujori i fundit i vitit 2023, ka reflektuar një zhvillim të ri në sektorin bankar, përmes emetimit për herë të parë të titujve financiarë me përparësi të lartë (senior), për qëllime të përmbushjes së kërkesave rregullative.

Më konkretisht, në dhjetor 2023, stoku i kapitalit bazë të nivelit të parë për bankat MREL vijoi prirjen rritëse në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 133.6 miliardë lekë, kundrejt nivelit 129.7 miliardë lekë që shënonte në fund të vitit 2022. Ky përmirësim reflekton ndikimin pozitiv të përfitueshmërisë së sektorit bankar që ka shërbyer për forcimin e vazhdueshëm të pozicionit bazë të kapitalit. Zhvillime pozitive ka shënuar edhe kapitali i nivelit të dytë, i cili arriti në nivelin 10.6 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej rreth 3.3 miliardë lekë, në vijim të emetimeve të reja të borxhit të varur gjatë vitit 2023.




Detyrimet e pranuar, që përbëhen kryesisht nga titujt financiarë me përparësi të lartë (senior), kanë shënuar një rritje të shpejtë gjatë vitit 2023. Në nivel stoku, detyrimet e pranuar shënuan një rritje vjetore me rreth 8 miliardë lekë, duke arritur në nivelin 10.5 miliardë lekë në dhjetor 2023. Ky stok përbëhet nga rreth 4.2 miliardë lekë borxh i varur i paklasifikuar si kapital rregullator (me një rritje të lehtë vjetore prej 1 miliardë lekësh), 3.2 miliardë lekë detyrime senior jo preferenciale dhe 3.1 miliardë lekë detyrime (senior) me përparësi të lartë të pakolateralizuara. Të dy këto instrumente financiare shënojnë emetimin për



herë të parë të titujve me përparësi të lartë (senior), për qëllime të përmbushjes së kërkesave rregullative në Shqipëri.


Në terma të kontributit në kapacitetin e MREL (grafik 5), kapitali bazë i nivelit të parë përbën kontribuesin kryesor, duke financuar mesatarisht rreth 92%-93% të totalit. Gjithsesi, për tremujorin e fundit të vitit 2023, rritja më e shpejtë e detyrimeve të pranuar është reflektuar në uljen e kontributit të këtij financimi, në rreth 86%. Kapitali i nivelit të dytë ka dhënë në vijimësi një kontribut në rritje në strukturën e financimit të MREL, duke reflektuar aktivitetin e vazhdueshëm të sektorit bankar në emetimin e borxhit të varur në tregun e brendshëm. Ky kapital ka financuar mesatarisht rreth 5%-6% të nivelit të MREL, duke shënuar një rritje më të shpejtë për tremujorin e fundit të vitit 2023, në rreth 7% të totalit. Kontributi që vjen nga borxhi i varur i paklasifikuar si kapital rregullator, paraqitet i qëndrueshëm në rreth 2%-3% të stokut të MREL. Së fundi, struktura e MREL ka shënuar zhvillime të rëndësishme në gjysmën e dytë të vitit 2023, pas emetimit nga bankat të instrumenteve senior, të cilat kanë financuar rreth 4% të tij.

Grafik 5. Struktura e financimit të MREL në përqindje, 2021-2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, kapitali bazë i nivelit të parë përbën mesatarisht 18.4% të EPR për vitin 2022 dhe 18.8% të EPR për vitin 2023 (grafik 6). Kapitali i nivelit të dytë ruan një qëndrueshmëri financimi në nivelet 1.1% -1.2% të EPR-ve për të gjithë periudhën, ndërsa borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator ka dhënë një kontribut të qëndrueshëm me rreth 0.4%-0.6% të EPR gjatë kësaj periudhe. Emetimet e titujve të njohur si detyrime senior, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për financimin e MREL vetëm në dhjetor 2023, duke arritur në total në rreth 0.9% të EPR.




Grafik 6. Struktura e financimit të MREL në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, 2021-2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet në ecurinë e kërkesës për MREL gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2023 (grafik 7), kanë reflektuar strategjinë e re të sektorit bankar për të ulur varësinë e financimit përmes kapitalit rregullator.

Grafik 7. Burimet e financimit të MREL në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, dhjetor 2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontributi i këtyre zhvillimeve në rritjen e kapacitetit të MREL gjatë pjesës së dytë të vitit 2023, është paraqitur në Grafikon 8. Në dhjetor 2023, niveli i MREL është rritur në 21.4% të EPR nga 20.2% që shënonte në qershor 2023, duke u përmirësuar me 1.2 pikë përqindje. Rritja e stokut të titujve të detyrimeve të pranuar (senior) me rreth 0.9 pikë përqindje ka dhënë kontributin kryesor në këtë përmirësim, ndjekur nga forcimi me 0.7 pikë përqindje i kapitalit rregullator (0.2 pikë përqindje përmes kapitalit bazë të nivelit të parë dhe 0.5 pikë përqindje përmes kapitalit të nivelit të dytë). Së fundi, stoku i borxhit të varur me maturitet të mbetur mbi 1 vit, që nuk klasifikohet si kapital rregullator,



ka kontribuar me rreth 0.2 pikë përqindje në rritjen e nivelit të MREL gjatë pjesës së dytë të vitit 2023.




Sektori bankar në Shqipëri ka vijuar të zgjerojë ndjeshëm aktivitetin bankar gjatë periudhës. Gjatë vitit 2023, ekspozimet e ponderuara me rrezik kanë shënuar një rritje prej 1.1% në terma vjetorë, ndërsa për pjesën e dytë të vitit, kjo rritje është përsheptuar në 2.6%. Në terma të kontributit relativ në nivelin e MREL për pjesën e dytë të vitit 2023, zgjerimi i vazhdueshëm i aktivitetit të sektorit bankar ka kontribuar në rënien me rreth 0.6 pikë përqindje të kapacitetit MREL në muajin dhjetor 2023.




III. ZHVILLIMET NË TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI PËR FINANCIMIN E MREL

Sektori bankar ka qenë vazhdimisht aktiv në financimin e kërkesave rregullative përmes emetimit në tregun e kapitalit në vend. Deri në vitin 2021, këto emetime kanë shërbyer për plotësimin e kërkesës për kapital rregullator, ndërsa pas vitit 2021, titujt financiarë të emetuar shërbejnë për të plotësuar njëkohësisht kërkesën për kapital rregullator dhe MREL.


Në total, duke përfshirë emetimet në të gjitha monedhat, përgjatë vitit 2023, sektori bankar ka emetuar një shumë prej 8.4 miliardë lekësh (nga 4.7 miliardë lekë në vitin 2022) në formën e obligacioneve me ofertë private. Ky emetim përfshin borxh të varur në vlerën 5.2 miliardë lekë dhe borxh të pagarrantuar në vlerën 3.2 miliardë lekë. Titujt financiarë të borxhit të varur janë detyrime të nënrenditura, të cilat emetohen për qëllime të kapitalit rregullator dhe shërbejnë njëkohësisht edhe për qëllime të financimit të MREL. Titujt financiarë të borxhit të pagarrantuar, janë detyrime senior të njohur si "detyrime të pranuar", të cilat shërbejnë për qëllime të financimit të MREL.



Specifikuar sipas monedhave, për vitin 2023, emetimi në monedhën vendase shënon 1.96 miliardë lekë, emetimi në euro shënon 6.3 miliardë lekë dhe në dollar 148 milionë lekë. 92% e totalit të titujve të borxhit të emetuar në tregun e kapitalit është kryer nga bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL, për një shumë prej 7.8 miliardë lekësh. Në vitin 2022, ky raport qëndronte në nivelin 25% të totalit, ku pjesa më e madhe e emetimeve kryhej prej bankave të tjera në sektor, për qëllime të kapitalit rregullator.




Grafik 10. Emetimet e letrave me vlerë sipas grupit të bankave në milionë lekë, 2021-2023



Burimi: Banka e Shqipërisë, AMF.


Në linjë me zhvillimet e sektorit në tërësi, emetimet në valutë zënë peshën kryesore për bankat MREL, veçanërisht për tremujorin e fundit të vitit 2023. Për këtë periudhë, vihet re një rritje e emetimeve të instrumenteve në monedhë të huaj në formën e "obligacioneve të pagarantuara", të cilat zënë 62% të stokut total kundrejt peshës në rënie të borxhit të varur, në rreth 38% të totalit.

Grafik 11. Emetimet e letrave me vlerë sipas monedhave për bankat MREL, në milionë Lekë, 2021-2023




Burimi: Banka e Shqipërisë, AMF.

Instrumentet e borxhit të varur kanë afate maturimi 7-vjeçare, pa reflektuar ndryshime përgjatë viteve. Ndërkohë, emetimet për herë të parë të titujve të borxhit të pagarantuar për qëllime të MREL, kanë reflektuar afate më të ulëta maturimi, në nivelin prej 4 vite për monedhën euro.



Kapaciteti i tregut të kapitalit për të përthithur këto emetime mbetet i kënaqshëm. Interesi në treg ka qenë më i madh për blerjen e emetimeve në lekë dhe euro, të cilat shënuan rritje më të madhe të normës së interesit dhe vlerë më të madhe të emetimeve.

Në lidhje me koston e emetimit në tregun e kapitalit, normat e interesit kanë shënuar rritje gjatë vitit 2023, në kushtet e rritjes në tërësi të normave të interesit në treg dhe emetimit të njëkohshëm të titujve të borxhit nga disa banka. Në nivel mesatar, gjatë vitit 2023, norma e interesit ka shënuar një rritje vjetore prej 2.1 pikë përqindjeje për emetimet në lekë, 0.9 pikë përqindjeje për emetimet në euro dhe 1.7 pikë përqindjeje për emetimet në dollarë. Piku i rritjes së normave të interesit është shënuar në tremujorin e tretë të vitit 2023, duke arritur në nivelet maksimale prej 7.5% për lekun dhe 5% për euron. Pavarësisht shtimit të aktivitetit të bankave në tregun e kapitalit për tremujorin e fundit të vitit, normat mesatare të interesit shënuan rënie në nivelin 6.5% për lekun dhe 4.3% për euron. Norma e interesit për monedhën dollar, duke qenë se nuk ka pasur numër të madh emetimesh, ka ruajtur stabilitetin e saj deri në emetimet e dy tremujorëve të fundit të vitit 2023, ku pëson një rritje me 1.5 pikë përqindje.



IV. NDIKIMI NË PËRFITUESHMËRI DHE NË KOSTON E FINANCIMIT TË SEKTORIT BANKAR

Ndikimi i përbushjes së kërkesës për MREL në përfitueshmërinë e sektorit bankar dhe koston përkatëse të financimit, është i dyanshëm. Ky ndikim përfshin: (i) efektin që vjen nga emetimi i titujve të rinj financiarë për të përbushur nivelin final të MREL dhe (ii) efektin që vjen nga kostoja e shërbimit të borxhit për titujt ekzistues në bilancin e sektorit bankar, të cilët janë të pranuar për MREL.

Në mënyrë të përmbledhur, gjatë vitit 2023, ecuria e normave të interesit është reflektuar në rritjen e marzhit neto nga interesi për sektorin bankar. Ky zhvillim ka përmirësuar ndjeshëm të ardhurat neto nga interesi për të gjithë sektorin, duke rritur aftësinë e tij për të përballuar koston shtesë të financimit të kërkesave të reja rregullative. Për rrjedhojë, pavarësisht rritjes së normave të interesit gjatë vitit 2023, kostoja e financimit të stokut të letrave me vlerë në bilancin e sektorit bankar mbeti e kufizuar, në kushtet e ruajtjes së treguesve të kënaqshëm të përfitueshmërisë. Ndërkohë, simulimet mbi ndikimin që mund të ketë emetimi në vijimësi i titujve të rinj financiarë për përbushjen e nivelit përfundimtar të MREL, janë të ndjeshme ndaj luhatjeve në normat e interesit në rastin e bankave të veçanta.


ZHVILLIMET NË PËRFITUESHMËRI

Ecuria e faktorëve të përgjithshëm të ekonomisë së brendshme dhe asaj të jashtme është reflektuar pozitivisht në përfitueshmërinë e sektorit bankar. Më konkretisht, prirjet e forta inflacioniste kanë ndikuar reagimin e bankave qendrore, duke kthyer ecurinë e normave bazë të interesit në një kah shtrëngues. Në linjë me zhvillime të ngjashme në tregun ndërkombëtar, edhe Banka e Shqipërisë ka rritur normën bazë të interesit nga 0.5% në fillim të vitit 2022, në 3.25% në fund të vitit 2023. Sektori bankar në Shqipëri i ka reflektuar këto ndryshime në normat përkatëse të investimit të aktivitetit të tij në aktiv dhe të financimit në pasiv.

Për rrjedhojë, në dhjetor 2023, rezultati neto nga interesi shënoi një rritje vjetore prej 15%, duke arritur në nivelin 67.3 miliardë lekë. Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL shënuan një rezultat neto nga interesi prej 50.8 miliardë lekësh, duke kontribuar në rreth 76% të totalit të sektorit. Në krahasim me një vit më parë, ky kontribut ka shënuar një rënie të lehtë me rreth 2 pikë përqindje, por vijon të mbetet në nivelin e mesatares afatgjatë.



Grafik 13. Rezultati neto nga interesi për sektorin dhe bankat MREL, 2020-2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në të njëjtën linjë, edhe treguesi i marzhit neto të interesit, i llogaritur si raporti i të ardhurave neto nga interesi ndaj aktiveve mesatare që sjellin të ardhura, ka reflektuar zhvillime pozitive. Në dhjetor 2023, ky tregues arriti në nivelin 4.3%, duke shënuar kështu vlerën maksimale që prej fillimit të vitit 2010. Bankat që i nënshtrohen kërkesës për MREL kanë ruajtur në përgjithësi një nivel lehtësisht më të ulët të marzhit neto nga interesi, në krahasim me bankat e tjera në sektor. Gjithsesi, gjatë vitit 2023 vërehet se hendeku midis nivelit të marzhit neto nga interesi për bankat MREL krahasuar me bankat e tjera, është ngushtuar. Gjatë kësaj periudhe, bankat MREL kanë reflektuar norma të këtij marzhi më pranë totalit të sektorit bankar edhe pas financimit të kërkesave rregullative, të cilat mund të sjellin shpenzime shtesë për këto banka.

Grafik 14. Marzhi neto nga interesi sipas grupit të bankave, 2020-2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.



ZHVILLIMET NË KOSTON E FINANÇIMIT


Në terma absolutë, ecuria e normës së interesit ndikon drejtpërdrejt në koston e financimit të MREL përmes emetimeve të titujve financiarë. Fokus të veçantë në këtë analizë kanë bankat të cilat kanë emetuar tituj borxhi, shpenzimet për interesa të të cilat kanë filluar të raportohen si zë i veçuar që prej fillimit të vitit 2023 në terma mujorë. Bankat kryejnë emetime të tilla për qëllime të përmbushjes së kërkesave për kapital rregullator ose për të përmbushur kërkesat për detyrime të pranuar (në rastin e bankave të cilat i nënshtrohen kërkesës për MREL).

Shpenzimet e interesit për klientët vijojnë të përbëjnë peshën kryesore të financimit të sektorit bankar. Në dhjetor 2023, pesha e shpenzimeve të interesit paguar klientëve qëndron në nivelin e 15.2% të rezultatit neto nga interesi. Nga ana tjetër, shpenzimet e interesit të paguar për borxhin e varur zënë një peshë mjaft më të vogël, me rreth 1.5% të rezultatit neto nga interesi.



Sipas grupit të bankave, treguesit për koston e financimit tregojnë për ruajtjen e strategjive të ngjashme të financimit ndërmjet bankave, por me një kosto më të ulët relative për bankat MREL. Në dhjetor 2023, për grupin e bankave të cilat i nënshtrohen kërkesave për MREL, shpenzimet e interesit paguar klientëve zënë 13.7% të rezultatit neto nga interesi, ndërsa shpenzimet e interesit për borxhin e varur zënë 1.4% të tij. Nga ana tjetër, grupi i bankave të tjera, gjithashtu paraqet shpenzim për interesa të borxhit të varur, të cilin e përdor për qëllime të përmbushjes së kërkesave për kapital rregullator. Në krahasim me bankat MREL, ky grup bankash shënon një peshë më të lartë të shpenzimeve të interesave të paguar, si për klientët (19.8%) ashtu edhe për borxhin e varur (1.6%).

Duke marrë në konsideratë stokun ekzistues të borxhit të varur të mbajtur nga sektori bankar, raporti midis shpenzimeve të interesit dhe stokut të borxhit të varur




shënoi një nivel prej 4.6% në fund të vitit 2023. Për grupin e bankave MREL, kjo peshë qëndron në nivelin e 4.7% për periudhën e analizuar, krahasuar me 4.2% për bankat e tjera. Raporti më i lartë i kostos së financimit të stokut ekzistues të borxhit për bankat MREL në krahasim me bankat e tjera, reflekton stokun më të lartë të borxhit që mbajnë këto banka në bilanc, si dhe një aktivitet më të hershëm të emetimit të titujve të borxhit, të cilët janë akumuluar në bilanc. Gjithsesi, kjo kosto është zbutur nga kostot relative më të ulëta të financimit përmes depozitave dhe prej ecurisë pozitive në përfitueshmëri për bankat MREL. Në çdo rast, kostoja e stokut ekzistues të borxhit të varur është përthithur dhe reflektuar në llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve të bankave, pa ndikuar ndjeshëm në rezultatin neto financiar të tyre.

Në total, në vijim të analizave të paraqitura në këtë seksion, vlerësohet se ndikimi ende i kufizuar i përmbushjes së kërkesave rregullative për MREL në bilancin e sektorit bankar është zbutur nga disa faktorë. Së pari, ruajtja e niveleve të kënaqshme të kapitalizimit të këtij grupi bankash ndër vite, ka lehtësuar procesin e përmbushjes së niveleve të ndërmjetme MREL, përmes kapitalit rezervë të lirë në bilanc. Së dyti, tregu i kapitalit në Shqipëri ka shfaqur aftësi të mira për të përthithur nevojat e bankave për financim, pa kosto shtesë për bankat që i nënshtrohen kërkesave për MREL.

Në tërësi, ruajtja e një besimi të shëndoshë të tregut në sektorin bankar është reflektuar në ruajtjen e kostove të financimit të titujve të borxhit, në nivele ende të përballueshme për përfitueshmërinë e sektorit. Në mënyrë të veçantë, bankat e mëdha që i nënshtrohen kërkesave për MREL, vijojnë të reflektojnë një peshë më të ulët të shpenzimeve për interesa ndaj të ardhurave neto (si për depozita, ashtu edhe për tituj borxhi) në krahasim me bankat e tjera. Së fundi, prania e filialeve të bankave evropiane, të cilat kanë zgjedhur të financojnë MREL përmes Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, ka lehtësuar në tërësi kërkesën për financim në tregun vendas, duke zbutur dhe presionet përkatëse në normën e interesit.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të monitorojë me kujdes zhvillimet në koston e financimit të kërkesave rregullative përgjatë periudhës tranzitore deri në fund të vitit 2027, në kushtet e rritjes graduale të nivelit të ndërmjetëm të kërkesës për MREL.




HAPËSIRË INFORMUESE: NDIKIMI I RITJES SË NORMAVE TË INTERESIT NË KOSTON E FINANCIMIT TË MREL

Analiza e mëposhtme vlerëson ndjeshmërinë e treguesve të përfitueshmërisë së bankave MREL, në rast se rritja e normës së interesit mund të rezultojë në kosto më të larta rifinancimi, në krahasim me periudhën në të cilën është emetuar fillimisht titulli i borxhit. Bankat të cilat kanë borxh të varur me maturim në afatin e mesëm mund të ndikohen më shumë prej ndryshimeve në normat e interesit.

Simulimet mbështeten në supozimin e një bilanci statik deri në vitin 2027, si dhe përmbushje të plotë të kërkesës MREL pa marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme në kërkesat rregullative mbikëqyrëse apo makroprudenciale gjatë kësaj periudhe. Analiza përjashton bankat që tashmë e plotësojnë nivelin përfundimtar të MREL-it dhe konsideron vetëm bankat që ende kanë nevojë të emetojnë tituj financiarë për të përmbushur objektivin final. Këto banka përbëjnë rreth 50.3% të aktiveve të sektorit bankar.

Ndikimi i përmbushjes së kërkesës MREL në përfitueshmërinë e bankave vlerësohet në dy drejtime. Së pari, vlerësohet kostoja e financimit të stokut aktual të detyrimeve të pranuar dhe së dyti, merren në konsideratë nevojat vjetore shtesë për financimin e MREL, deri në arritjen e objektivit përfundimtar në vitin 2027. Skenari bazë nuk parashikon ndryshime në normën e interesit gjatë periudhës 2024-2027. Dy skenarët hipotetikë supozojnë një rritje të normës së interesit përkatësisht me 1 dhe 2 pikë përqindjeje gjatë kësaj periudhe.

Grafik 16. Ndikimi i ndryshimit të normës së interesit në shpenzimet e interesit të borxhit (në terma mesatarë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e analizës të paraqitur në Grafikon 16 tregojnë se kostoja e financimit të MREL paraqitet e përballeshme duke arritur në 5.7% të të ardhurave neto nga interesat në vitin 2027. Për të gjitha bankat, kostoja e financimit të detyrimeve të pranuar mund të përthithet plotësisht në rezultatin neto financiar të tyre, pa ndikuar ndjeshëm në terma të përfitueshmërisë. Gjithsesi, duhet theksuar se analiza nuk merr në konsideratë përforcimin e vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit të bankës përmes kapitalizimit të fitimit, i cili parashikohet të zbusë pjesërisht nevojën e sektorit bankar për të financuar MREL përmes emetimit të borxhit të ri. Nëse në analizë përfshihet dhe ky faktor, kostoja e financimit të MREL zvogëlohet ndjeshëm në kushtet e treguesve të kënaqshëm të



përfitueshmërisë për vitin 2023 që mund të shërbejnë për forcimin e mëtejshëm të kapitalit rregullator.

Rezultatet e skenarëve hipotetikë tregojnë se kostoja për shërbimin e borxhit për qëllime të MREL mund të shënojë rritje të mëtejshme, por mbetet e kufizuar në terma relativë të treguesve të përfitueshmërisë. Në çdo rast, sektori bankar vijon të raportojë vlera të kënaqshme të rezultatit neto nga interesi dhe të treguesve të përfitueshmërisë, edhe në skenarët më të rënduar.

